Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 dhe 12.2 shkronja d), nenit 68 paragrafi 68.4, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040"Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28 e datës 04.06.2008, nenit 26 pika 3, të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5 të dt.31.10.2019, sipas nenit 6 pika 1.6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.28.04.2023, bie këtë:

V E N D I M

PËR VËNIEN NË DISKUTIM PUBLIK TË DRAFT – STRATEGJISË PËR INFORMIM DHE KOMUNIKIM TË KOMUNËS SË DEÇANIT 2023-2027

I.

Miratohet Vendimi për vënien në Diskutim Publik të Draft-Strategjisë për Informim dhe Komunikim të Komunës së Deçanit 2023-2027.

II.

Vënia në Diskutim Publik e Draft-Strategjisë për Informim dhe Komunikim të Komunës së Deçanit 2023-2027, bëhet me qëllimin e dhënies së kontributit nga Institucionet, ekspertët e fushës përkatëse, grupet e interesit dhe qytetarët, në mënyrë që Strategjia të jetë sa më funksionale për subjektet implementuese dhe të tjerët.

III.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit, si dhe publikimit në ueb faqen e Komunës.

IV.

Vendimi bëhet transparent përmes publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës,Tabelës së shpalljeve dhe Zyrës për Informim të Komunës së Deçanit.

01.Nr.IV-2
Deçan,dt.28.04.2023

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

K.K. Deçan AS 13889
01 10.05.23

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 dhe 12.2 shkronjat (c dhe d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040"Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28 e datës 04.06.2008, nenit 21 paragrafi 1, të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5 të dt.31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.28.04.2023, bie këtë:

V E N D I M

MBI THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR PËRPUNIMIN DHE HARMONIZIMIN E DRAFT – STRATEGJISË PËR INFORMIM DHE KOMUNIKIM TË KOMUNËS SË DEÇANIT 2023-2027

I.

Themelohet Komisioni për përpunimin dhe harmonizimin e Draft-Strategjisë për Informim dhe Komunikim të Komunës së Deçanit 2023-2027, në këtë përbërje:

1. Hajdar Sutaj (AAK)-Kryesues i Komisionit, me anëtarë 2.Florim Mataj (AAK), 3.Floriana Hulaj (AAK), 4.Blinera Lokaj(LDK), 5.Teuta Neziraj (LVV), 6.Mon Selmonaj(PDK), 7. Dafina Cacaj (Ekzekutivi), 8. Dyke Llolluni (Zyra e Kuvendit) dhe 9.Edone Kameraj(Zyra për Informim).

II.

Detyrë e Komisionit është që të bëjë përpunimin e Draft-Strategjisë për Informim dhe Komunikim të Komunës së Deçanit dhe t'a harmonizon ate me Statutin e Komunës dhe të gjitha ligjet në fuqi. Pas përgatitjes së tekstit të Draft-Strategjisë për Informim dhe Komunikim dhe harmonizimit me dispozitat e Statutit të Komunës dhe të gjitha Ligjeve në fuqi, Komisioni i dorëzon materialin për shqyrtim dhe miratim KPF-së dhe Kuvendit.

III.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

IV.

Me nga një kopje të Vendimit paisen, të emruarit në pikën I. dhe Arhivi.

01.Nr.IV-2/1
Deçan,dt.28.04.2023

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT
Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

K.K.Deçan AS 13884
01 10.05.23

Sipas LMFPP dhe Ligjin Nr.08/L-193 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 të datës: 30.12.2022, në bazë të nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja (b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008), nenit 26 pika 2. të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, me Rekomandim të Ministrisë së Financave-shkresa e dt.14 Prill 2023, Kuvendi i Komunës së Deçanit pas Ri-shqyrtimit të vendimit të Kuvendit të dt.28.02.2023, në mbledhjen e mbajtur me dt.28.04.2022, merr këtë:

VENDIM

PËR BARTJEN E TË HYRAVE VETANAKE NGA VITI PARAPRAK 2022 NË VITIN AKTUAL FISKAL 2023

I.

Me këtë Vendim bëhet bartja e të hyrave vetanake nga viti paraprak 2022 në vitin aktual fiskal 2023, sipas LMFPP dhe Ligjin Nr.08/L-193 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 të datës: 30.12.2022.

*Totali për bartje është shuma prej **183.174,58€** fondi burimor(21),* si në pasqyrën e paraqitur më poshtë:

- *Programi Buxhet dhe financa nën programi buxhetimi kategoria ekonomike _Mallra dhe Shërbime bartet shuma totale prej **27,552.92** euro, apo **21/631/17515/130/00000/0112..... shuma 27,552.92 euro (për hapjen e procedurave tenderuese për vlerësim të pronave komunale).***

- Programi nenprogrami Zyra e Kryetarit Kategoria ekonomike _Subvencione dhe transfere bartet shuma totale **8,028.00** euro,
  21/631/16015/200/00000/0111..... shuma 8,028.00 euro

- Programi shërbime Publike mbrojtje civile dhe emergjente Infrastruktura rrugore kategoria ekonomike Investimeve kapitale bartet shuma totale **147,593.66€** euro,

• projektin me kod 21/631/18015/300/52958/0451 Mirëmbajtja verore dhe dimerore e rrugëve ne komunën e Deçanit, kontrata ne vlerë prej **1,876,165.50Euro**, dhe obligime janë **93,813.66** Euro,

  - Shuma prej **93,813.66€** Obligime ndaj Kompanisë së kontraktur "Lika Trade" për punët e kryera

• projektin me kod 21/631/18015/300/53127/0451 Ndërtimi i Qendrës rinore ne Deçan – Pune shtese, vlera e kontratës **43,780.00€** dhe obligime janë **33,780.00** €

  - shuma prej **33,780.00€** obligime ndaj kompanisë "Nb Projekt" për punët e kryera

• projektin me kod 21/631/18015/300/52958/0451 Asfaltimi dhe rregullimi i infrastrukturës te çerdhja e fëmijëve ne Deçan. vlera e kontratës **137,886.63€** dhe obligime janë **20,000.00€**

  - shuma prej **20,000.00€** obligime ndaj kompanisë "Arfa Group" për punet e kryera

II.

Për ekzekutimin e këtij vendimi do të kujdesen: - Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe Drejtoritë tjera relevante të Komunës së Deçanit.

KK Deçan AS 13887
01 10.05.23

III.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

IV.

Me Vendim njoftohen: MF-Departamenti për Buxhet dhe Financa, MAPL, Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoritë tjera relevante dhe Arkivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.IV-3
Deçan,dt.28.04.2023

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

Në bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit Nr.32 Protokoli, datë 05.05.2018 dhe Nr.Protokolit 14050, datë 15.05.2018, Nr.3270 Protokoli, datë 06.06.2022 dhe Nr.18701 Protokoli, datë 07.06.2022 ndërmjet Komunës së Deçanit- Kosovë dhe Qendra "Integrim e Zhvillim Demokratik"- Shqipëri;
Memorandumi i Bashkëpunimit (Aktpartneriteti) Nr. 3270/1 Protokol, datë 18.08.2022 ndërmjet Komunës së Deçanit-Kosovë dhe Qendra "Itegrim e Zhvillim Demokratik"-Shqipëri; Programi IPA 2 Shqipëri – Kosovë.
Sipas nenit 14 paragrafi 14.1, nenit 17 shkronja (a, b, c), nenit 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008), dhe nenit 15 pika 1, 2 dhe 3. të Statutit të Komunës së Deçanit 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.28.04.2023, merr këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NGRITJEN E NDËRMARRJES TË KULTIVIMIT RRITJES DHE TREGËTIMIT TË FIDANEVE DEKORATIVE DHE FRUTORE

I.

Me këtë vendim caktohet lokacioni për ngritjen e Ndërmarrjes së Kultivimit, Rritjes dhe Tregëtimit të fidanëve dekorative dhe frutore, sipas Memorandumit të Bashkëpunimit Nr.32 Protokoli, datë 05.05.2018 dhe Nr.Protokolit 14050, datë 15.05.2018, Nr.3270 Protokoli, datë 06.06.2022 dhe Nr.18701 Protokoli, datë 07.06.2022 ndërmjet Komunës së Deçanit- Kosovë dhe Qendra "Integrim e Zhvillim Demokratik"- Shqipëri; dhe Memorandumit të Bashkëpunimit (Aktpartneriteti) Nr. 3270/1 Protokol, datë 18.08.2022 ndërmjet Komunës së Deçanit-Kosovë dhe Qendra "Itegrim e Zhvillim Demokratik"-Shqipëri; Programi IPA 2 Shqipëri – Kosovë.

II.

Caktohet lokacioni për ngritjen e Ndërmarrjes së Kultivimit, Rritjes dhe Tregëtimit të fidanëve dekorative dhe frutore, në parcelën nr.00542-0, me sipërfaqe 611 m2, parcela nr.00545-0 me sipërfaqe 2303 m2, parcela nr.00544-0 me sipërfaqe 716 m2, parcela nr.00543-0 me sipërfaqe 771 m2, parcela nr.00550-0 me sipërfaqe 6117 m2 Njësia Kadastrale, Zona Kadastrale Deçan, e evidentuar si pronë komunale pronar-KOMUNA E DEÇANIT.

III

Për ekzekutimin e këtij vendimi do të kujdesen:Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër të Komunës së Deçanit.

IV.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

V.

Me Vendim njoftohen: MAPL, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim, Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Arhivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.IV-5/1
Deçan,dt.28.04.2023

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

REPUBLIC OF KOSOVA
KK Deçan AS 12794
01 28.04.2023

REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA • KOMUNA E DEÇANIT • OPSTINA DEÇANE • Drejtoria për Administratë • Odeljenje za administraciju • DEÇAN MUNICIPALITY

Duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 12.2 shkronja d) dhe nenin 17 pika (o) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/ L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008), Nenit 11 të Ligjit për Sistemin e Adresave në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-071, si dhe nenit 26 pika 6 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, Kuvendi Komunal Deçan, pasi analizoi listën rezervë për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në territorin e Komunës së Deçanit, të dt.23.05.2013, Kuvendi i Komunës së Deçanit, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.04.2023 mori këtë:

V E N D I M
PËR SHQUQIZIMIN E VENDIMIT TË DT.25.03.2013

PËR APROVIMIN E LISTËS REZERVË PËR EMËRTIMIN E RRUGËVE DHE SHESHEVE NË KOMUNËN E DEÇANIT

I.

Shfuqizohet Vendimi i Kuvendit i dt.25.03.2013, me të cilin është Aprovuar lista rezervë për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe hapësirave publike në territorin e Komunës së Deçanit, sipas kësaj tabele:

Nr.	Emri i rrugës	Kodi i rrugëve	Z.Q.P
1.	24 Marsi		Rrugë
2.	Vëllezërit Frashëri		Rrugë
3.	Lidhja e Prizrenit		Rrugë
4.	Kuvendi i Junikut		Rrugë
5.	Kosova		Rrugë
6.	Luigj Gurakuqi		Rrugë
7.	Habsburgët		Shesh
8.	Shqiponjat e Zeza		Shesh
9.	Adem Jashari		Rrugë
10.	Zahir Pajaziti		Rrugë
11.	Lan Dobra		Rrugë
12.	Bajrush Doda		Rrugë
13.	Plava		Rrugë
14.	16 Qershori		Rrugë
15.	Gjeneralëve		Rrugë
16.	Anton Qeta		Rrugë
17.	Kongresi i Manastirit		Rrugë
18.	Shkronjave		Rrugë
19.	Jeton Dedushaj		Rrugë

Kuvendi Komunal 13883
01 10.05.23

20.	Nijazi Ferizi		Rrugë
21.	Zeqë Hasaj		Rrugë
22.	Myrvete Maksutaj		Rrugë
23.	Beqir Vokshi		Rrugë
24.	Metë Hysen Vokshi		Rrugë
25.	Butrinti		Rrugë
26.	Dardania		Rrugë
27.	Pishat e Deçanit		Rrugë
28.	Kalishta		Rrugë
29.	Tahir Sinani		Rrugë
30.	Shotë Galica		Rrugë
31.	Naim Frashëri		Rrugë
32.	Sami Frashëri		Rrugë
33.	Ibrahim Rugova		Rrugë
34.	Ismail Qemali		Rrugë
35.	8 Marsi		Rrugë
36.	17 Shkurti		Rrugë
37.	Arbërit		Rrugë
38.	Berlini		Rrugë
39.	Londra		Rrugë
40.	Mbretëresha Teutë		Rrugë
41.	Ulpiana		Rrugë
42.	Rilindja		Rrugë
43.	Gryka e Deçanit		Rrugë
44.	Besa Besë		Rrugë
45.	Flamuri		Rrugë
46.	Krujës		Rrugë
47.	Kuvendi i Lezhës		Rrugë
48.	Minatori		Rrugë
49.	Beteja e Pozharit		Rrugë
50.	Dushkaja		Rrugë
51.	Parisi		Rrugë
52.	Tafil Kasumaj		Rrugë
53.	Shaban Kasumaj		Rrugë
54.	Pleqja		Rrugë
55.	Roshkodoli		Rrugë
56.	Fehmi Agani		Rrugë
57.	Din Mehmeti		Rrugë
58.	Ali Podrimja		Rrugë
59.	Bekim Fehmiu		Rrugë
60.	Faruk Begolli		Rrugë
61.	Shpella e Bojkut		Rrugë
62.	Mylishevci		Rrugë
63.	28 Nëntori		Rrugë
64.	Shkodra		Rrugë
65.	Beteja e Slivovcs		Rrugë
66.	Dom Lush Gjergji		Rrugë
67.	Lugina e Preshevës		Rrugë
68.	Regjep Kadrijaj		Rrugë

69.	7 Marsi		Rrugë
70.	Lidhja e Pejës		Rrugë
71.	Fatmir Nimanaj		Rrugë
72.	Bashkim Ferizaj		Rrugë
73.	Bylbyl Ferizaj		Rrugë
74.	Hajdar Pepaj		Rrugë
75.	Ismet Ferizaj		Rrugë
76.	Përparim Ferizaj		Rrugë
77.	Nimon Musaj		Rrugë
78.	Naser Idrizaj		Rrugë
79.	Qazim Shala		Rrugë
80.	Shaqë Ferizaj		Rrugë
81.	Jakub Demalijaj		Rrugë
82.	Arsen Mazrekaj		Rrugë
83.	Arif Idrizaj		Rrugë
84.	Altin Haskaj		Rrugë
85.	Brahim Demalijaj		Rrugë
86.	Bajram Lekaj		Rrugë
87.	Mujë Gërvalla		Rrugë
88.	Gani Rrustemaj		Rrugë
89.	Islam Lekaj		Rrugë
90.	Kujtim Gjukaj		Rrugë
91.	Musë Shala		Rrugë
92.	Xheladin Lekaj		Rrugë
93.	Jetmir Mazrekaj		Rrugë
94.	Xhevat Tolaj		Rrugë
95.	Abedin Sumaj		Rrugë
96.	Berhan Dervishaj		Rrugë
97.	Sylë Shala		Rrugë
98.			Rrugë
99.			Rrugë
100.			Rrugë

II.

Komisioni Komunal për emërim të rrugëve pas shfuqizimit të këtij vendimi do të fillon me procedurat e përgaditjes dhe hartimit të listës së re rezervë për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Deçanit.

III.

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive Komunale, Zyrës për informim, Kryetarit të Komunës, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrisë për Punë të Brendshme, Ministrisë për Planifikimin Hapësinor, Agjensionit Kadastral të Kosovës si dhe Entit Statistikor të Kosovës.

01. Nr. IV-5/2
Deçan, dt. 28.04.2023

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, në harmoni me Ligjin Nr.04\L-071 për Sistemin e Adresave, si dhe në bazë të nenit 26 pika 6 dhe pika 9 të Statutit të Komunës së Deçanit 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit , në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.28.04.2023, bie këtë:

V E N D I M

MBI NDRYSHIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL PËR EMËRTIMIN DHE RIEMËRTIMIN E SHESHEVE, RRUGËVE DHE LAGJEVE URBANE I DT.31.01.2022

I.

Me këtë Vendim bëhet ndryshimi i Komisionit për emërtimin dhe riemërtimin e Shesheve, Rrugëve dhe Lagjeve Urbane, në teritorin e Komunës së Deçanit, të emëruar me Vendimin e dt.31.01.2022.

APROVOHET dorëheqja e parevokueshme e anëtareve të Komisionit:

1. Elmedina Sadikaj(AAK),
2. Floriana Hulaj(AAK),
3. Yllarta Thaqi (AAK),

Komisioni do të Plotësohet me tre anëtarë mbledhjen e radhës të Kuvendit të Komunës.

II.

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Kryesuesi i Kuvendit.

IV.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

V.

Me Vendim paisen të përmendurit në pikën I. Të Vendimit, Kryetari i Komunës dhe Arhivi.

01.Nr.IV-5/3
Deçan,dt.28.04.2023

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

K. Komunal 13888
01 10.05.23

Në bazë të nenit 11, nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja (d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040"Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28 e datës 04.06.2008, sipas nenit 8 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3, nenit 10 paragrafi 2 të Ligjit për Mbeturina Nr.04/L-060 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-071, nenit 5 paragrafi 5.2 të Rregullores Komunale për Menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Deçanit, 01.Nr.I-5, dt.31.01.2019, dhe nenit 15 pika 6 të Statutit të Komunës së Deçanit 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit pasi Rishqyrtoi Vendimin 01.Nr.III-6, për miratimin e Planit për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027, të miratuar me dt.30.03.2023, me Rekomandim të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës Nr.1926-2/23 dt.20.04.2023, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.28.04.2023, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE 2023-2027

I.

Miratohet Plani për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027 në territorin e Komunës së Deçanit.

II.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është akti komunal me emërtimin, Plani për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027 në territorin e Komunës së Deçanit.

III.

Për ekzekutimin e këtij Vendimi kujdesen: Drejtoria për Shërbime Publike e Komunës së Deçanit.

IV.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

V.

Me Vendim njoftohen: MPL, Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Arkivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.IV-5/4
Deçan,dt.28.04.2023

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

K.K Deçan AS 13882
01 10.05.23